



*VENDIM*

*Nr. 114, Datë 08.07.2016*

**PER MIRATIMIN E RREGULLORES PER TRAJTIMIN E ANKESAVE TË  
PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR ZGJIDHJEN E  
MOSMARREVESHJEVE MIDIS TE LICENCUARVE NE SEKTORIN E  
ENERGJISE ELEKTRIKE DHE TE GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika ë; neni 24, pika 1 dhe 2 te Ligji Nr.43/2015,“Për Sektorin e Energjise elektrike”; neni 17, pika ë; neni 98, pika 1 dhe 2 te Ligjit Nr.102/2015 “Per Gazin Natyror”; dhe neni 26 të “Rregullore se organizimit, funksionimit dhe procedurave te ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s, Nr.96 date 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës \_\_.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te ERE,në lidhje me miratimin e “Për miratimin e rregullore se per trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis te licencuarve ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror”

**Konstatohet se:**

- ERE eshte organi kompetent per hartimin dhe miratimin e kesaj Rregulloreje.
- Me vendimin Nr. 92, Datë 09.06.2016 Bordi I ERE ka miratuar “Fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullore se per trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis te licencuarve ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror””

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

**Vendos:**

[https://ere.gov.al/doc/Rregullorja\\_per\\_zgjidhjen\\_e\\_mosmarreveshjeve.pdf](https://ere.gov.al/doc/Rregullorja_per_zgjidhjen_e_mosmarreveshjeve.pdf)

1. Të miratojë“Rregulloren per trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis te licencuarve ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë te interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**